



Shqiperia me ne fund ka frenuar renien e lire ne renditjen e FIFA-s. Barazimi ne miqesoren e zhvilluar ne Turqi me Bjellorusine ka sjelle ngritjen me nje vend ne klasifikimin e FIFA-s per kombetaren Shqiptare. Keshtu kuqezinjte e drejtuar nga De Biasi tashme jane te pozicionuar ne vendin e 57 te klasifikimit boteror. Pasi humben 13 shkalle menjehere ne renditjen e muajit Tetor, kuqezinjte nisen ringritjen. Barazimi ne miqesoren me Bjellorusine ka bere qe Shqiperia te fitoje 8 pike, pasi nga 563 pike qe kishte ne muajin tetor, ne renditjen e re numeron 571 pike.